



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2022

VENDIM
Nr. 162, datë 29.04.2022
PËR
NDRYSHIMIN E PJESSHËM TË VENDIMIT NR.161, DATË 28.04.2022 TË
KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 113 e 117 të Kodit të Procedurave Administrative, në nenet 2, 89 e 99 të ligjit nr.115/2019 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, si dhe në email-in datë 29.04.2022 të Gjykatës së Apelit Vlorë, pasi shqyrtoi relacionin dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës,

VENDOSI:

- I. Ndryshimin e pikës I, nënndarja “Gjykata Apelit Vlorë”, faqe 2, të Vendimit Nr.161, datë 28.04.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në këtë mënyrë:

“Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, Miranda Andoni, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen gjyqësore me të pandehur: {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}”, me akuzë “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal”, si edhe çdo kërkesë tjetër që ka lidhje me objektin e procedimit penal të regjistruar në gjykatën e apelit Vlorë, me nr.1278, datë 06.12.2021 regjistri themeltar.”

- II. Një kopje e vendimit t’i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarit përkatës të caktuar për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR